

**LIGJ**  
**Nr.10 081, datë 23.2.2009**

**PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

*(Ndryshuar me ligjet nr. 6/2015, datë 12.2.2015, nr. 131/2015, datë 26.11.2015, nr. 37/2016, datë 31.3.2016; nr. 21/2021, datë 22.2.2021, nr. 72/2021, datë 27.5.2021; nr. 41/2025, datë 26.6.2025)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.

**Neni 2**

**Objekti dhe fusha e veprimit**

*(Shfuqizuar shkronja "d" e pikës 1 me ligjin nr. 131/2015, datë 26.11.2015; shtuar pika 3 me ligjin nr. 41/2025, datë 26.6.2025)*

1. Ky ligj përcakton:

- a) parimet për përcaktimin e veprimtarive, të veprimeve dhe tipave të të mirave publike, ushtrimi, kryerja dhe përdorimi i të cilave u nënshtrohet licencimit, autorizimit apo lejimit;
- b) parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave, autorizimeve e lejeve dhe parimet për shkaqet e procedurat e revokimit të tyre;
- c) organizimin dhe përmbajtjen e Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve;
- ç) procedurat për trajtimin e disa licencave, të autorizimeve dhe lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore;

d) Shfuqizuar.

2. Ligji është i zbatueshëm për:

- a) të gjitha licencat e autorizimet, për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe të çdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake;
- b) të gjitha lejet për përdorimin e të mirave publike, për qëllime të veprimtarive të sipërpërmendura, përveç përdorimit të të mirave publike për qëllime vetjake.

3. Ky ligj zbatohet pa rënë ndesh me legjislacionin në fuqi për shëndetin e kafshëve, që

përcakton rregullat për miratimin e regjistrimit e stabilimenteve të kafshëve dhe të stabilimenteve të materialit riprodhues të kafshëve.

### Neni 3

#### **Përkufizim i termave**

*(ndryshuar shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 me ligjin nr. 131/2015, datë 26.11.2015)*

1. Në këtë ligj termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a) "Ministria" është ministria përgjegjëse për tregtinë.
  - b) "Minister" është ministri përgjegjës për tregtinë.
  - c) "Ministër përgjegjës" është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi, për një licencë/autorizim/leje të caktuar.
  - ç) "Institucion qendror" është Këshilli i Ministrave, çdo ministri dhe çdo institucion publik në varësi të tyre.
  - d) "Institucion i pavarur" është çdo institucion i pavarur, sipas Kushtetutës apo i krijuar me ligj dhe çdo organ i njësive të pushtetit vendor, që ka në kompetencë dhënien e një licence, autorizimi apo lejeje.
  - dh) "Institucion tjetër" është çdo institucion qendror ose i pavarur, që ka kompetenca të caktuara për verifikimin e përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe çdo subjekt privat, të cilit i është dhënë, sipas ligjit, një kompetencë e tillë.
  - e) "Veprimtari" është çdo veprimtari e natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprimtari tjetër e ngjashme, që nuk është e natyrës vetjake.
  - ë) "Veprim" është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngjashëm, që nuk është i natyrës vetjake, i cili kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie, që licencohet apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mire publike, që i nënshtrohet apo jo pajisjes me leje.
  - f) "E mirë publike" është pronë e paluajtshme publike e shtetit, sipas legjislacionit përkatës, si dhe të mira të tjera të natyrës publike, si: ajri, ujërat, burimet natyrore, mjedisi, në përgjithësi, trashëgimia kulturore, frekuenca dhe të tjera të kësaj natyre, sipas legjislacionit në fuqi.
  - g) "Përdorim i së mirës publike" është e drejta për të administruar një të mirë publike, për të gëzuar frytet e saj, për t'ia ndryshuar karakteristikat fizike, për ta përdorur si lëndë, për të përdorur hapësirën për ndërtime, për të shkarkuar mbetje në mjedis, si dhe forma të tjera përdorimi të këtyre natyrave, për qëllimet apo nevojat e një veprimtarie, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.
  - gj) "Licencë" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
  - h) "Autorizim" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të kryejë një apo disa veprime, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
  - i) "Leje" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të përdorë një të mirë publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
  - j) "Titullar i licencës/autorizimit/lejes" është personi juridik apo personi fizik, që ka marrë një licencë, autorizim apo leje.
  - k) "Kushte të licencimit/autorizimit/lejimit" janë ato kushte, përmbushja paraprake dhe/ose në vazhdimësi e të cilave nga titullari i licencës/autorizimit/lejes është e detyrueshme.
  - l) "Kritere të licencimit/autorizimit/lejimit" është ajo pjesë e kushteve, nga përmbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës/autorizimit/lejes.
  - ll) "Detyrime të licencimit/autorizimit/lejimit" është ajo pjesë e kushteve, që kërkohen të përmbushen përgjatë kryerjes së veprimtarisë, të veprimit apo përdorimit të së mirës publike.
  - m) "Dokument provues" është akti shkresor i një institucioni publik, privat apo akti i përgatitur nga vetë kërkuesi e që provon përmbushjen e një kushti licencimi/autorizimi/lejeje.
  - n) "Dokument tjetër shoqërues" është një dokument i detyrueshëm për t'u paraqitur, për pajisjen me licencë/autorizim/leje e që nuk është dokument provues.

n) "Dokumente shoqëruese" janë dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese e të marra së bashku.

o) "Kërkues" është personi fizik apo juridik, që kërkon pajisjen me licencë, autorizim apo leje.

p) "QKB" është Qendra Kombëtare e Biznesit.

q) "Regjistër" është Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

2. Në kuptim të këtij ligji, vlerësohen licencë, autorizim apo leje të gjithë termat e përdorur në legjislacionin tjetër në fuqi, të tillë, si: certifikatë, pëlqim, regjistrim, njoftim, notifikim, kontratë apo edhe vetë termat licencë, leje, autorizim, si dhe çdo term tjetër, kur, sipas qëllimit në legjislacionin përkatës, kuptimi i atij termi përkon, përkatësisht, me kuptimin e termave licencë, autorizim ose leje, të përcaktuar në këtë ligj.

## KREU II

### PARIMET E NISMAVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUSHËN E LICENCIMIT, AUTORIZIMIT DHE LEJEVE

#### Neni 4

#### **Nismat në fushën e licencave/autorizimeve/lejeve**

Çdo nismë e një projektligji apo akti nënligjor, që propozon parashikimin në legjislacionin shqiptar të:

- a) një licence për ushtrimin e një veprimtarie;
  - b) një lejeje për përdorimin e një të mire publike;
  - c) një autorizimi për kryerjen e një veprimi;
  - ç) kushteve të licencimit, autorizimit apo lejimit;
  - d) dokumenteve shoqëruese për pajisjen me një licencë, autorizim apo leje;
  - dh) procedurave të shqyrtimit dhe të vendimmarrjes, për pajisjen me një licencë, autorizim apo leje;
  - e) afateve të vlefshmërisë së një licence/autorizimi/lejeje;
  - ë) organit kompetent për inspektimin apo revokimin e licencës/autorizimit/lejes dhe/ose shkaqeve e procedurave të pezullimit dhe/ose revokimit të tyre;
- duhet të jetë për secilën nga këto çështjet e sipërpërmendura, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenet 5 deri në 12 të këtij kreu.

#### Neni 5

#### **Parimet e përgjithshme**

1. Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

2. Përdorimi i të mirave publike në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet, si rregull, vetëm nga subjektet, që janë lejuar për këtë, në bazë të një lejeje, sipas legjislacionit në fuqi, përveçse kur e mira publike, për shkak të natyrës dhe karakteristikave të saj, është për përdorim të lirë të publikut të gjerë apo parashikohet ndryshe me ligj.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj, ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo

leje.

#### Neni 6

### **Parimet për përcaktimin e veprimtarive që u nënshtrohen licencimit dhe autorizimit**

Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi nëpërmjet licencimit apo, përkatësisht, autorizimit bëhet vetëm nëse plotësohen këto dy rrethana:

a) ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunksionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat sociale dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre;

b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëpasshëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përbushjes së disa kriterëve të paracaktuara, përpara fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit.

#### Neni 7

### **Parimet për përcaktimin e veprimtarive që i nënshtrohen lejes**

Përdorimi i një të mire publike, nëpërmjet një lejeje, bëhet vetëm nëse plotësohet, të paktën, njëra nga këto rrethana:

a) kur nëpërmjet procesit të dhënies së lejes, synohet marrja e kundërvlehtës më të mirë në interes publik;

b) përdorimi i lirë i së mirës publike nga subjekte, që nuk zotërojnë njohuritë, teknologjitë apo garanci të tjera të nevojshme, shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj ose një shfrytëzim të papërshtatshëm;

c) kur e mira publike, për shkak të kufizimit të saj në sasi, shtrirje, hapësirë apo kohë, ose për shkak të rrethanave të tjera, të arsyeshme, nuk lejon, përveçse një numër të kufizuar përdoruesish apo përdorim të kufizuar, ose kur përdorimi i lirë i së mirës publike nga një numër i pakufizuar subjektesh apo pa kufizim në sasi dhe/ose shtrirje në hapësirë dhe/ose kohë shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj apo një shfrytëzim të papërshtatshëm.

#### Neni 8

### **Parimet për përcaktimin e kushteve të licencimit/autorizimit**

1. Kushtet e licencimit apo autorizimit bazohen në parimet e proporcionalitetit, deburokratizimit dhe uljes së barrierave administrative.

2. Kushtet e licencimit apo autorizimit duhet t'u përgjigjen, në mënyrë të përshtatshme, interesave publike që ato garantojnë dhe mund të jenë: aftësi profesionale apo fizike, përvojë apo njohuri, mënyrë organizimi, zotërimi i një teknike apo teknologjie të caktuar, gjendje apo garanci pasurore, gjendje juridike apo norma të sjelljes e të etikës.

3. Kushtet e licencimit apo autorizimit përcaktohen e shprehen, bazuar në tregues objektivë, të matshëm, të thjeshtë e të kuptueshëm.

4. Çdo kërkues, që plotëson kriteret e licencimit apo autorizimit, fiton të drejtën që ta ushtrojë atë veprimtari apo, përkatësisht, ta kryejë atë veprim.

5. Përrjashtësisht, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, sipas nenit 6 të këtij ligji, mund të përcaktohet një kufizim sasior i veprimtarive apo veprimeve, nëpërmjet kufizimit të numrit të licencave për atë veprimtari, apo autorizimeve për atë veprim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, nisma ligjore përcakton që licenca apo

autorizimi i jepet një numri të kufizuar kërkesish që, përveçse plotësojnë kriteret bazë të licencimit apo, përkatësisht, autorizimit, arrijnë, gjithashtu, vlerësimin më të mirë, krahasuar me kërkesit e tjerë, në përputhje me disa kriteret dhe procedura konkurruese, të paravendosura, transparente e të drejta.

#### Neni 9

### **Parimet për përcaktimin e kushteve të lejimit**

1. Kushtet e lejimit, për çdo lloj të mire publike, bazohen në parimet e ruajtjes, të shtimit dhe mirëpërdorimit të së mirës publike, maksimizimit të përfitimit publik, si dhe të proporcionalitetit, deburokratizimit dhe mosdiskriminimit të padrejtë.

2. Kushtet e lejimit përcaktohen e shprehen bazuar, sa më shumë të jetë e mundur, në tregues objektivë, të matshëm, të krahasueshëm, të thjeshtë e të kuptueshëm.

3. Kriteret e lejimit duhet t'u përgjigjen, në mënyrë të përshtatshme, interesave publikë, që garantojnë dhe mund të jenë kualifikuese dhe/ose konkurruese.

4. Kriteret kualifikuese shërbejnë për të përzgjedhur kërkesit, që përmbushin kërkesat minimale dhe/ose të domosdoshme për përdorimin e së mirës publike. Vlerësimi i plotësimit të kriterëve kualifikuese mund të jetë pjesë e një procesi lejimi ose një procesi paraprak licencimi. Në këtë rast, licencimi është kusht paraprak, i domosdoshëm për lejimin.

5. Kriteret konkurruese shërbejnë për të përcaktuar kërkesin, që ofron përdorimin më të përshtatshëm dhe/ose kundërvleftën më të mirë, krahasuar me kërkesit e tjerë, që kanë përmbushur kriteret kualifikuese. Konkurrimi bazohet në procedura e kriteret të paravendosura, transparente e të drejta.

#### Neni 10

### **Parimet për përcaktimin e procedurave të licencimit, autorizimit dhe lejimit**

1. Vlerësimi i plotësimit të kriterëve të licencimit, të autorizimit apo dhënies së lejes bazohet, sipas rastit, në: vetëdeklarimet e kërkesit, dokumentet e lëshuara nga organe të tjera publike apo institucione të tjera private, kryerjen e vlerësimeve, inspektimet paraprake apo organizimin e testeve, të provimeve, garave, intervistave, dëgjimit ose të metodave të tjera të përshtatshme.

2. Procedurat për trajtimin e kërkesave për licenca, autorizime e leje duhet të jenë të qarta, të thjeshta, transparente dhe të mbështeten, sa më shumë të jetë e mundur, në:

a) miratimin e heshtur;

b) mjetet elektronike të informimit e të komunikimit, përfshirë aplikimin on line;

c) modelin e qendrës me një ndalesë;

ç) shkëmbimin e integruar të informacionit e të dokumentacionit ndërmjet organeve publike;

d) pagesën për shërbimin administrativ të licencimit/autorizimit/lejes, kur parashikohet, e cila duhet të mbulojë vetëm koston dokumentare;

dh) taksat dhe/ose tarifat për dhënien e licencave/autorizimeve/lejeve, kur parashikohen, duhet të jenë të arsyeshme e në funksion të arritjes së qëllimeve të këtyre instrumenteve.

Këto procedura duhet të kryhen në kohën më të shkurtër të mundshme.

3. Kur dokumentet që provojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit, autorizimit apo lejes ose të dhënat e deklaruara nga kërkesi janë në regjistrat elektronikë të institucioneve publike dhe janë të aksesueshme nga organi publik, ku bëhet kërkesa, kërkesi nuk detyrohet t'i paraqesë ato dokumente, me kushtin që ai të tregojë qartë në kërkesë-referencën e këtyre të dhënave në regjistrin përkatës.

4. Organet publike, që kanë kompetencë në procesin e dhënies së licencave, autorizimeve apo lejeve, në çdo rast, sigurojnë, nëpërmjet faqeve të tyre zyrtare të internetit dhe mjeteve të tjera

të përshtatshme, informimin e plotë të të interesuarve e të publikut për kuadrin ligjor, kriteret, procedurat, afatet, format e aplikimit dhe dokumentet shoqëruese të kërkuara, si dhe ofrojnë shërbime këshillimi për kërkuuesin.

#### Neni 11

##### **Parimet për përcaktimin e afateve të vlefshmërisë së licencës, autorizimit dhe lejes**

1. Afati i parashikuar i vlefshmërisë së licencës/autorizimit/lejes duhet të jetë i përshtatshëm për arritjen e qëllimit.

2. Vlefshmëria e një licence duhet të jetë, si rregull, pa afat e, në rast të kundërt, afati të jetë aq më i gjatë, sa ka arsye të besohet se kushtet e licencimit do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre, në mënyrë të përshtatshme, përgjatë këtij afati.

3. Afati i vlefshmërisë së një lejeje duhet të jetë aq i gjatë, sa ka arsye të besohet se kushtet e lejimit do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre, në mënyrë të përshtatshme, përgjatë këtij afati.

4. Afati i vlefshmërisë së një autorizimi duhet të jetë aq i gjatë, sa të lejojë kryerjen normale të veprimit të autorizuar.

#### Neni 12

##### **Parimet për përcaktimin e shkaqeve dhe të procedurave, për revokimin e licencës/autorizimit/lejes**

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

2. Konstatimi i mosplotësimit të kritereve apo shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit ex poste.

3. Përpara marrjes së vendimit të revokimit, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrit për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

4. Urdhri i pezullimit revokohet nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.

5. Licenca/autorizimi/leja, si rregull, revokohen:

a) kur rrethanat janë të tilla, që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

b) në rast të moszbatimit të urdhërimeve, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;

c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi.

#### Neni 13

##### **Procedurat për nismat ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit, të autorizimit dhe lejeve**

1. Çdo nismë normative në fushën e licencimit/autorizimit/lejimit, sipas nenit 4 të këtij ligji, shpallet publikisht në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në faqen zyrtare të internetit dhe me mjete të tjera të përshtatshme, të paktën 30 ditë para shqyrtimit të tij përfundimtar nga organi miratues. Në rastin e projektligjeve, për të cilat të drejtën e nismës e ushtron Këshilli i Ministrave, shpallja bëhet 30 ditë përpara paraqitjes për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga ministri përgjegjës dhe ministri.

2. Shpallja, sipas pikës 1 të këtij neni, përmban, të paktën, raportin e vlerësimit të pasojave,

sipas pikës 5 të këtij neni dhe projekt-aktin përkatës.

3. Gjatë kësaj kohe, çdo organ tjetër publik, çdo palë e interesuar apo publiku mund të dërgojnë vërejtje. Brenda kësaj periudhe, organi nismëtar organizon, të paktën, një dëgjim publik, për t'u njohur me sugjerimet e organeve të tjera apo të palëve të interesuara.

4. Çdo nismë, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqërohet, në procesin e shqyrtimit dhe të miratimit, përveç sa parashikohet nga legjislacioni në fuqi, edhe me këto dokumente:

- a) mendimin këshillimor të Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- b) raportin e vlerësimit të pasojave.

5. Raporti i vlerësimit të pasojave përmban informacion të hollësishëm për objektivat dhe qëllimet e nismës, opsionet për arritjen e objektivave, krahasimin e opsioneve të ndryshme, pasojat e pritshme të opsionit të propozuar, përputhjen e opsionit të propozuar me secilin nga parimet e këtij ligji, një përmbledhje të këshillimeve publike të zhvilluara dhe vërejtjet e propozimet e bëra gjatë këtyre këshillimeve.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rregulla të hollësishme për procedurën e vlerësimit të pasojave dhe përmbajtjen e raportit përkatës.

### KREU III

### REGJISTRI KOMBËTAR I LICENCEVE, AUTORIZIMEVE DHE LEJEVE

#### Neni 14

#### **Regjistri Kombëtar i Licenceve, Autorizimeve dhe Lejeve**

*(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 7 me ligjin nr.6/2015, datë 12.2.2015, shfuqizuar pika 7)*

1. Çdo licencë/autorizim/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licenceve, Autorizimeve dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

2. Regjistri Kombëtar i Licenceve, Autorizimeve dhe Lejeve është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

3. Regjistri organizohet në tri pjesë:

- a) regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve;
- b) regjistri informativ, sipas kategorive të licenceve, autorizimeve dhe lejeve;
- c) regjistri aplikativ i licenceve dhe lejeve.

4. Regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore përmban të gjitha projektaktet e nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve, raportin përkatës të vlerësimit të pasojave dhe mendimin këshillimor të QKB-së.

5. Regjistri informativ përmban, për çdo kategori licence/autorizimi/lejeje, të paktën, këto lloje të dhënash:

- a) kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- b) kriteret dhe detyrimet e licencimit, të autorizimit apo lejimit, dokumentet shoqëruese, që duhen paraqitur dhe formularët e aplikimit;
- c) procedurat e aplikimit, të shqyrtimit dhe vendimmarrjes;
- ç) udhëzimet për bërjen e kërkesave.

6. Regjistri aplikativ përmban këto të dhëna:

a) çdo kërkesë për pajisjen me licencë/autorizim/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;

b) çdo vendim të ndërmjetëm të institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licencimit/lejimit;

- c) çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë;
- ç) çdo vendim për urdhërimin e ripërmbyshjes së kritereve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licencës/autorizimit/lejes apo pezullimin e licencës/autorizimit/lejes;
- d) çdo vendim për revokimin e një licence/autorizimi/lejeje;
- dh) çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “d” të kësaj pike;
- e) çdo licencë/autorizim/leje të dhënë e të vlefshme;
- ë) vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një licence/autorizimi/lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licencuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të së mirës publike;
- f) çdo vendim tjetër për një licencë/autorizim/leje të caktuar.

#### 7. Shfuqizohet

8. Regjistri Kombëtar mbahet nga QKB-ja, e cila siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të tij. QKB-ja, çdo institucion i pavarur dhe çdo institucion qendror, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, janë përgjegjës për administrimin dhe plotësimin, sipas këtij ligji, të Regjistrit Kombëtar për pjesën e licencave/autorizimeve/lejeve në kompetencë të tyre.

9. Organi nismëtar i nismës ligjore, me përjashtim kur është institucioni i përmendur në pikën 8 të këtij neni, dërgon projekt-aktin dhe raportin e vlerësimit të pasojave për publikim nga QKB-ja.

10. Çdo institucion tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, me kompetencë në shqyrtimin e kritereve të licencimit/autorizimit/lejes, ka akses në Regjistrin Kombëtar, për të publikuar vendimin e tij në procesin e shqyrtimit të kërkesës për licencim/autorizim/leje.

11. Çdo institucion me kompetenca të caktuara për trajtimin e një kërkesë ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtpërdrejtë në regjistrë, për të publikuar kërkesat, ankimet dhe vendimet përkatëse dhe është i detyruar për të publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligji.

12. Vendimet e gjykatës, sipas shkronjave “dh” dhe “ë” të pikës 6 të këtij neni, i njoftohen nga vetë gjykata, brenda 5 ditëve nga dhënia e tyre, institucionit që administron regjistrin për licencën/autorizimin/lejen, sipas kompetencës përkatëse. Njoftimi bëhet me mjete të përshtatshme.

13. Regjistri është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Ministri miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e regjistrit, krijimin, administrimin, formatimin, përmbytjen, lidhjen në rrjet me institucionet e përfshira në procesin e licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe procedurat e sigurisë së tij.

## KREU IV

### KOMPETENCAT PËR TRAJTIMIN E LICENCAVE/AUTORIZIMEVE/LEJEVE TE INSTITUCIONEVE QENDRORE

#### Neni 15

#### **Kompetenca për trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.6/2015, datë 12.2.2015)*

1. Licencat dhe lejet, sipas fushave dhe kategorive, në kompetencë të institucioneve qendrore, parashikohen në shtojcën që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Fushat e autorizimeve, në kompetencë të institucioneve qendrore, janë të njëjtat me fushat për licencat dhe lejet, që parashikohen në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Parashikimi i kategorive të tjera të licencave/autorizimeve/lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore, nga ato të paparashikuara në shtojcë, është i mundur vetëm nëpërmjet ndryshimit të kësaj shtojce.

3. Kërkesat për licencat dhe lejet e parashikuara në shtojcë apo nënkategoritë e tyre, si dhe për autorizimet, sipas fushave të parashikuara në shtojcë, apo kategoritë e nënkategoritë e tyre trajtohen:

a) si rregull, nga apo nëpërmjet QKB-së;  
b) në raste të veçanta, nga organet e përcaktuara sipas legjislacionit përkatës në fuqi, pa përfshirjen e QKB-së.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, përcakton:

a) nënkategori të licencave, autorizimeve e të lejeve, të parashikuara në shtojcë;  
b) kategori dhe nënkategori të autorizimeve, sipas fushave të parashikuara në shtojcë;  
c) licencat, autorizimet dhe lejet apo nënkategoritë e tyre, kërkesat për të cilat trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së, sipas kreut V të këtij ligji.

## KREU V PROCEDURAT E LICENCIMIT/AUTORIZIMIT/LEJIMIT NGA APO NPËRMJET QKB-SË

### SEKSIONI 1 NDARJA NË GRUPE

#### Neni 16 **Grupet e licencave/autorizimeve/lejeve**

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, miraton ndarjen e licencave, të autorizimeve dhe lejeve dhe/ose nënkategorive të tyre, që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së, në një nga tre grupet e përcaktuara në pikat 2, 3 e 4 të këtij neni.

2. Grupi i parë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve bazohet vetëm në vetëdeklarimet e kërkuarit.

3. Grupi i dytë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve, përveçse në vetëdeklarimet e kërkuarit, bazohet, për të paktën njërin nga kushtet, edhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuari.

4. Grupi i tretë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat, përveç sa parashikohet në pikat 2 e 3 të këtij neni, vlerësimi i përmbushjes së kriterëve, për të paktën njërin prej tyre, bazohet edhe në kryerjen e një procesi inspektimi, testimi, gare, interviste, dëgjimi apo metode tjetër vlerësimi.

### SEKSIONI 2 KËRKESA, SHQYRTIMI DHE VENDIMARRJA

#### Neni 17 **Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet**

1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKB, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.

2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.

3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;  
b) llojin e veprimtarisë, veprimi apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;  
c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;  
ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimi apo përdorimit të së mirës;  
d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;

dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);

e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

ë) adresën për komunikim;

f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKB-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKB-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

#### Neni 18

### **Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e parë**

1. QKB-ja merr në shqyrtim kërkesat për grupin e parë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 2 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

2. QKB-ja shqyrton:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin, nëse është personi që mund të paraqesë kërkesën, sipas këtij ligji;

b) plotësimin e plotë e të saktë të të gjitha të dhënave të detyrueshme, të kërkuara në formular;

c) paraqitjen e të gjitha dokumenteve të tjera shoqëruese, nëse kërkohen;

ç) përmbushjen apo jo të kriterëve, përkatësisht, të licencimit/autorizimit/lejimit;

d) pagesën e tarifës së shërbimit.

3. Shqyrtimi i përmbushjes së kriterëve për grupin e parë, sipas shkronjës “ç” të pikës 2 të këtij neni, bazohet vetëm në vetëdeklarimin e kërkuarit.

4. QKB-ja refuzon kërkesën nëse:

a) personi, që ka paraqitur kërkesën, nuk është personi që mund të paraqesë kërkesën, sipas këtij ligji;

b) formulari i plotësuar nuk është i plotë apo përmban korrigjime dhe përmbajtja e tij nuk duket qartë apo është e pallexueshme;

c) nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese, ato nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e pallexueshme;

ç) kërkuari nuk përmbush kriteret përkatëse të licencimit/autorizimit/lejimit;

d) nuk është kryer pagesa e tarifës së shërbimit.

5. Nëse rast të kundërt, QKB-ja e miraton kërkesën.

#### Neni 19

### **Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e dytë**

1. QKB-ja shqyrton, sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji, kërkesat për grupin e dytë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 4 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës. QKB-ja shqyrton edhe paraqitjen e të gjitha dokumenteve provuese.

2. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit bazohet vetëm në vetëdeklarimet dhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuari.

3. Refuzimi dhe miratimi i kërkesës bëhen për shkak, sipas pikave 4 e 5 të nenit 18 të këtij ligji.

4. Kërkesa refuzohet edhe nëse nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet provuese, ato nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas

dispozitave përkatëse, ose kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme.

#### Neni 20

##### **Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë**

*(Ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 37/2016, datë 31.3.2016)*

1. QKB-ja merr në shqyrtim paraprak, sipas pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

2. QKB-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kriterëve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate, sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të tjera të licencimit/autorizimit/lejes bëhet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni.

3. Nëse QKB-ja konstaton njëra nga shkaqet e refuzimit, ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.

4. Në rast të kundërt, QKB-ja publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, me mjete elektronike, institucionet e tjera, që shqyrtojnë përmbushjen e një apo të disa kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencë të tyre.

5. Institucionet e tjera, brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektimin, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përmbushjen ose mospërmbushjen e kriterëve përkatëse. Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.

6. Nëse akti i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është, paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtit kriter apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institucion tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.

7. Afati i caktuar, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, është afati për shqyrtimin e përmbushjes ose jo të kriterit përkatës nga institucioni tjetër dhe përcaktohet nga Këshilli i Ministrave për çdo kategori/nënkategori. Afati fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKB-së, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.

9. Jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i afatit të fundit dhe më të gjatë, sipas pikës 5 apo 6 të këtij neni, QKB-ja merr një vendim përfundimtar për kërkesën e paraqitur.

10. Nëse, qoftë edhe një nga institucionet e tjera ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKB-ja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundërt QKB-ja vendos, përkatësisht, miratimin.

#### Neni 21

##### **Kombinimi i procedurave**

1. Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji nga apo nëpërmjet QKB-së dhe për të cilat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/lejes bëhet për një pjesë të kriterëve që përpara fillimit të veprimtarisë, ndërsa vlerësimi i përmbushjes së pjesës tjetër të kriterëve bëhet vetëm pas një periudhe të caktuar të ushtrimit të veprimtarisë, trajtohen si më poshtë:

a) procedura kalon në këta dy hapa: licencë/autorizim/leje e përkohshme dhe licencë/autorizim/leje përfundimtare;

b) licenca/autorizimi/leja e përkohshme, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, është me afat të përcaktuar, sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe titullari duhet të paraqesë kërkesën për pajisjen

me licencën/autorizimin/lejen përfundimtare, përpara përfundimit të afatit të asaj të përkohshme.

2. Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji, nga apo nëpërmjet QKB-së dhe për të cilat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përmbushjes së kushteve të licencimit/autorizimit/lejimit bëhet me dy hapa dhe në hapin e dytë shqyrtohet vetëm kërkesa e subjektit që ka kaluar me sukses hapin e parë, trajtohen si më poshtë:

a) procedura kalon në këta dy hapa: miratimi i kalimit me sukses të hapit të parë dhe licencimi/autorizimi/lejimi përfundimtar;

b) pas njoftimit nga QKB-ja të vendimit të miratimit për kalimin me sukses të hapit të parë, kërkuesi duhet të paraqesë dokumentet shoqëruese për hapin e dytë brenda afatit përkatës.

3. Trajtimi i secilit prej hapave të parashikuar në shkronjën “a”, përkatësisht, të pikave 1 e 2 të këtij neni, u nënshtrohet, sipas rastit, procedurave të këtij ligji për grupin e parë, të dytë apo të tretë. Këshilli i Ministrave përcakton grupin, sipas të cilit trajtohet secili hap.

#### Neni 22

##### **Përmbajtja e vendimit dhe miratimi i heshtur**

1. Vendimi i miratimit apo i refuzimit të kërkesës bëhet sipas formularit tip e njoftohet sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.

2. Vendimi i refuzimit përmban të gjitha shkaqet e refuzimit, ndërsa vendimi për miratim përmban edhe të dhënat e llogarinë bankare përkatëse, si dhe vlerën e taksës/tarifës që duhet paguar, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

3. Vendimi i refuzimit, i bërë sipas pikës 10 të nenit 20 të këtij ligji, përmban edhe vendimin, sipas formularit tip të institucionit tjetër që ka vendosur refuzimin.

4. Riparaqitja e kërkesës pas refuzimit trajtohet si kërkesë e re.

5. Në rastin kur QKB-ja, brenda afatit të përcaktuar, sipas këtij kreu, nga paraqitja e kërkesës, nuk publikon vendimin e refuzimit apo të miratimit, atëherë kërkesa quhet automatikisht e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik gjeneron menjëherë vendimin e miratimit. Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik në regjistrë.

6. Pika 5 e këtij neni nuk zbatohet për kërkesat për grupin e tretë nëse edhe vetëm njëri nga institucionet e tjera, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, ka vendosur refuzimin.

#### SEKSIONI 3

##### **TITULLI I LICENCËS/AUTORIZIMIT/LEJES DHE LËSHIMI I TIJ**

#### Neni 23

##### **Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes**

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.

2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emrin dhe stemën e QKB-së;

b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;

c) të dhënat për identifikimin e titullarit;

ç) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;

d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);

dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimin apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka);

e) afatin e vlefshmërisë;

ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKB-së dhe vulën përkatëse të institucionit;

f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;

g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

#### Neni 24

##### **Hyrja në fuqi e licencës/autorizimit/lejes dhe prova e tij**

1. Licenca, autorizimi apo leja hyn në fuqi menjëherë, me publikimin e titullit përkatës në regjistrë, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

2. Në rastet kur për përfitimin e titullit nuk është e zbatueshme një tarifë apo taksë, titulli publikohet në regjistrë menjëherë dhe automatikisht, së bashku me njoftimin e vendimit të miratimit, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji, apo menjëherë me gjenerimin e miratimit të heshtur, sipas pikës 5 të nenit 22 të këtij ligji dhe mund të tërhiqet në çdo sportel shërbimi të QKB-së apo të printohet drejtpërdrejt nga regjistri.

3. Në rastet kur për përfitimin e titullit është e zbatueshme një tarifë apo taksë:

a) QKB-ja bën, menjëherë, shënimin përkatës në regjistrë nëse kërkuesi paraqet dokumentin e pagesës së taksës/tarifës. Titulli publikohet automatikisht dhe menjëherë në regjistrë dhe mund të tërhiqet në çdo sportel shërbimi të QKB-së apo të printohet drejtpërdrejt nga regjistri;

b) vendimi i miratimit, së bashku me dokumentin e pagesës së taksës/tarifës, zëvendësojnë titullin përkatës nëse QKB-ja nuk bën shënimin e pagesës së taksës/tarifës.

4. Nëse aplikohet një taksë apo tarifë dhe kërkuesi nuk paraqet provën e pagesës brenda afatit 30 ditë kalendarike nga publikimi i vendimit të miratimit, titulli vlerësohet automatikisht i revokuar dhe QKB-ja bën shënimin përkatës në regjistrë, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

#### Neni 25

##### **Zëvendësimi i titullit**

1. Në rast humbjeje apo dëmtimi të titullit, titullari njofton QKB-në dhe i kërkon zëvendësimin e titullit. Kërkesa bëhet sipas procedurave të këtij ligji dhe formularit të miratuar.

2. QKB-ja anulon titullin dhe e zëvendëson atë brenda 2 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës, duke bërë edhe shënimin përkatës në regjistrë.

#### SEKSIONI 4

##### **NDRYSHIMET, SHTYRJA E AFATIT DHE REVOKIMI**

#### Neni 26

##### **Ndryshimi i të dhënave të titullit, që nuk kanë të bëjnë me kriteret**

1. Kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë, veprimit apo përdorimit të së mirës ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titull e të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, ky ndryshim i njoftohet, brenda 30 ditëve, QKB-së, me kërkesë të titullarit.

2. Kërkesa bëhet sipas procedurave të përcaktuara për grupin e parë dhe duhet të përmbajë të dhënat e reja, që kërkohen të ndryshohen.

3. Kur QKB-ja vëren se ka të bëjë me një rast të tillë, bën ndryshimet përkatëse dhe lëshon titullin e ndryshuar brenda 2 ditëve nga data e bërjes së kërkesës.

#### Neni 27

##### **Ndryshimi i të dhënave të titullit, që kanë të bëjnë me kriteret**

1. Kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë, veprimit apo përdorimit të së mirës ndodh

ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin përkatës e të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, ky ndryshim, pavarësisht se mund të cenojë apo jo këto kriteret, duhet t'u njoftohet nga titullari i titullit, menjëherë QKB-së dhe institucioneve të tjera përkatëse, që kanë marrë pjesë në dhënien e atij titulli. Kur ndryshimet janë të tilla, që mund të cenojnë kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, titullari duhet të pezullojë, me nismën e vet, veprimtarinë, veprimin apo përdorimin e së mirës publike.

2. Titullari duhet të kërkojë verifikimin, nëse këto ndryshime çojnë në vazhdimin e vlefshmërisë së titullit me ndryshimet përkatëse apo në revokimin e tij.

3. Kërkesa për të dhënat që ndryshojnë bëhet sipas nenit 17 të këtij ligji dhe shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, sipas të njëjtit grup, për të cilin është bërë kërkesa për vetë titullin.

4. Kur vlerësohet se ndryshimet e ndodhura nuk cenojnë kriteret, titullari pajiset me titullin e ndryshuar, afati i vlefshmërisë së të cilit mbaron në të njëjtën datë me atë të titullit të mëparshëm.

5. Kur vlerësohet, sipas këtij ligji, se ndryshimet e ndodhura cenojnë kriteret, titulli revokohet.

#### Neni 28

#### **Shtyrja e afatit të licencës/autorizimit/lejes**

1. Shtyrja e afatit të titullit është e mundur vetëm kur është parashikuar në legjislacionin e posaçëm dhe vetëm në bazë të kushteve të parashikuara në të.

2. Kërkesa për shtyrjen e afatit trajtohet e shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, e të njëjtit grup, sipas këtij ligji.

#### Neni 29

#### **Revokimi i licencës/autorizimit/lejes**

1. Titujt e lëshuar, sipas këtij kreu, revokohen sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.

2. Titulli revokohet edhe nga QKB-ja në këto raste:

a) me kërkesë të titullarit;

b) për mospagim të taksës/tarifës përkatëse (nëse ka);

c) për konstatim të të dhënave të pavërteta në dokumentet e paraqitura në QKB;

ç) për mosnjohim të ndryshimit të të dhënave, sipas nenit 26 apo 27 të këtij ligji.

3. QKB-ja merr vendimin për revokimin e titullit në afatin e 2 ditëve pune nga përcaktimi i shkaqeve të revokimit.

4. Në rastin e revokimit të titullit, taksa/tarifa e paguar nuk kthehet.

#### SEKSIONI 5

#### ANKIMI

#### Neni 30

#### **Ankimi**

*(Ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 37/2016, datë 31.3.2016)*

1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të QKB-së apo institucionit tjetër në rastin e grupit të tretë.

2. Ankimi administrativ shqyrtohet nga titullari i QKB-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

3. Në rastin e refuzimit të parashikuar në pikën 10 të nenit 20 të këtij ligji, ankimi shqyrtohet nga institucioni tjetër, që e ka vendosur refuzimin.

4. Ankimi, në të gjitha rastet, paraqitet me kërkesë në QKB, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, QKB-ja publikon ankimin dhe njofton,

me mjete elektronike, institucionin tjetër kompetent.

5. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ apo mosveprimit mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

## SEKSIONI 6

### MËNYRAT E PARAQITJES SË KËRKESAVE E NJOFTIMEVE NË DHE NGA QKB-JA, PUBLIKIMET DHE MIRATIMI I AKTEVE TË TJERA NËNLIGJORE

#### Neni 31

##### **Paraqitja e kërkesave në QKB**

*(Ndryshuar shkronja "c" me ligjin nr. 37/2016, datë 31.3.2016)*

Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës/taksës në QKB mund të kryhen nëpërmjet:

- a) paraqitjes drejtpërdrejt në çdo sportel shërbimi të QKB-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së kërkuarit;
- b) dërgimit me postë me lajmërim-marrje në selinë qendrore të QKB-së;
- c) sportelit elektronik të QKB-së, në përputhje me parashikimet e kreut V të këtij ligji.

#### Neni 32

##### **Paraqitja në sportelet e QKB-së**

1. Kërkesa paraqitet në sportelin e QKB-së nga vetë kërkuarisi apo çdo person i autorizuar prej tij.
2. Nëpunësi i sportelit asiston të interesuarin në plotësimin e formularit të kërkesës, verifikon identitetin dhe kërkon nënshkrimin e formularit të plotësuar.
3. Dokumentet shoqëruese paraqiten në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin apo në kopje të shoqëruara me origjinalin, që njësohen me origjinalin nga nëpunësi i sportelit.
4. Kur kërkesa paraqitet nga personi i autorizuar, sipas pikës 1 të këtij neni, bashkë me dokumentet shoqëruese paraqitet edhe dokumenti që vërteton faktin e të qenit i autorizuar.
5. Nëpunësi i sportelit lëshon një konfirmim, me shkrim, për çdo kërkesë. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë llojin e kërkesës, datën dhe listën e dokumenteve shoqëruese të dorëzuara.
6. Nëpunësi i sportelit është i detyruar të marrë në dorëzim çdo kërkesë të paraqitur, sipas këtij ligji, edhe nëse kërkesa është e paplotë.
7. Dokumenti i pagesës së tarifës/taksës paraqitet në sportel, nëpunësi i të cilit lëshon një konfirmim me shkrim.

#### Neni 33

##### **Paraqitja me postë**

1. Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës/taksës së licencës/autorizimit/lejes në QKB mund të kryhen edhe me postë me lajmërim-marrje.
2. Formulari i plotësuar i kërkesës/njoftimit, në rastin e paraqitjes me postë, nënshkruhet nga personat përgjegjës, për përfaqësimin e personit juridik apo vetë personi fizik.
3. Dokumentet bashkëlidhur paraqiten në kopje të njësuara me origjinalin.
4. Bashkë me dokumentet shoqëruese paraqitet edhe një kopje e dokumentit të identifikimit të personit që ka nënshkruar formularin.
5. Në bazë të marrëveshjes me organet e shërbimit postar, nëpunësi i shërbimit postar

lëshon konfirmimin, sipas pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

6. Data e paraqitjes së kërkesës në QKB është data e përcaktuar në lajmërim-marrje.

Neni 33/1

### **Veprimet pranë sportelit elektronik**

*(Shtuar me ligjin nr. 37/2016, datë 31.3.2016)*

1. Çdo individ, pasi të jetë identifikuar elektronikisht, ka të drejtë që, në cilësinë e aplikantit apo të personit të autorizuar, të aplikojë pranë sportelit elektronik për pajisjen me një licencë/autorizim/leje apo veprim tjetër, sipas këtij ligji, përfshirë këtu procedurat e ankimit administrativ, dhe të marrë nga QKB-ja, nëpërmjet këtij sporteli, të gjitha aktet përkatëse të parashikuara nga ky ligj.

2. Veprimet pranë sportelit elektronik të QKB-së, për të cilat ky ligj kërkon identifikimin elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për identifikimin elektronik të sigurt, kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën, nëpërmjet nënshkrimit elektronik të kualifikuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

Neni 34

### **Njoftimi i vendimeve nga QKB-ja dhe dorëzimi i titullit**

1. Vendimet e QKB-së, sipas këtij ligji, njoftohen nëpërmjet publikimit në regjistër.
2. Data e njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është data e publikimit në regjistër.
3. Titulli përkatës i dorëzohet kërkuarit në sportel.

Neni 35

### **Afati i publikimi në regjistër**

Çdo kërkesë dhe çdo vendim i QKB-së apo i një institucioni tjetër, që lidhet me licencimin/autorizimin/lejimin, sipas këtij kreu, publikohet në regjistër brenda ditës së nesërme të punës nga paraqitja e kërkesës apo marrja e vendimit ose e bërjes me dije.

Neni 36

### **Miratimi i procedurave dhe i formateve standard**

*(Shtuar pika 4 me ligjin nr. 37/2016, datë 31.3.2016)*

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, miraton:
  - a) procedurat e hollësishme të trajtimit të kërkesave të licencave/autorizimeve/lejeve dhe të nënkategorive të tyre;
  - b) kriteret e posaçme të licencimit/autorizimit/lejimit për secilën nga kategoritë e nënkategoritë, dokumentet shoqërues, formën dhe përmbajtjen e dokumenteve shoqëruese, si dhe afatin e vlefshmërisë së titullit përkatës;
  - c) detyrimet e posaçme të licencimit/autorizimit/lejimit për secilën nga kategoritë e nënkategoritë e tyre, sipas delegimit nga legjislacioni përkatës i posaçëm;
  - ç) institucionet e tjera kompetente, që vlerësojnë përmbushjen e kriterëve, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, si dhe metodat e afatet përkatëse;
  - d) aktet e tjera nënligjore, të përcaktuara në këtë kre.
2. Ministri, së bashku me ministrin përgjegjës miratojnë:
  - a) formularët e kërkesave me përmbajtjen e hollësishme të rubrikave të tyre, për çdo kategori e nënkategori të licencave/autorizimeve/lejeve;

- b) formularët për titujt e licencave/autorizimeve/lejeve dhe të anekseve përkatëse.
3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton formularët për llojet e tjera të kërkesave, të njoftimeve që bëhen në QKB, sipas këtij ligji, si dhe ato të vendimeve të QKB-së.
4. Ministri përcakton kushtet dhe rregullat e hollësishme teknike për ofrimin e shërbimeve nga QKB-ja nëpërmjet sportelit elektronik.

## KREU VI KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QKB-SË

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2015, datë 26.11.2015)*

## KREU VII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT HYRJA NË FUQI

### Neni 52 **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë ndryshimet në të gjitha ligjet e tjera, për aq sa është e nevojshme, për sigurimin e koherencës ligjore me këtë ligj dhe t'ia paraqesë ato Kuvendit në trajtën e një pakete të vetme.
2. Ngarkohen Këshilli i Ministrave, ministri dhe ministri përgjegjës që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj.
3. Ngarkohen Këshilli i Ministrave, ministrat dhe organet e tjetra që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të posaçme, të miratojnë akte normative nënligjore në fushën e lejeve, të autorizimeve dhe licencave dhe të përshtatin aktet nënligjore, sipas rastit, në përputhje me parimet dhe dispozitat e këtij ligji.

### Neni 53 **Dispozita kalimtare**

1. Licencat/autorizimet/lejet kompetencë e institucioneve qendrore, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin, për të cilin janë lëshuar.
2. Ngarkohen të gjitha institucionet qendrore, që kanë lëshuar licenca/autorizime/leje deri në afatin e parashikuar në pikën 2 të nenit 55 të këtij ligji e që të cilat, sipas këtij ligji, trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së, t'i dërgojnë QKB-së të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin që publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve e Lejeve, brenda këtij afati.
3. Ngarkohen të gjitha institucionet e pavarura dhe institucionet qendrore, të përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, të publikojnë, brenda datës 31 dhjetor 2009, në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e përcaktuar, sipas parashikimeve të këtij ligji për licencat/autorizimet/lejet e vlefshme e të dhëna prej tyre deri në këtë datë.
4. Deri në bërjen funksional të sistemit elektronik të komunikimit me QKB-në, për grupin e tretë të licencave/autorizimeve/lejeve, afateve të parashikuara për:
- a) publikimin e vendimit paraprak nga QKB-ja, sipas pikës 4 të nenit 20 të këtij ligji;
  - b) publikimin e vendimit të institucionit tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji;
- t'u shtohen, përkatësisht, nga 2 ditë kalendarike për dërgimin/marrjen e vendimit me postë me lajmërim-marrje.

### Neni 54 **Shfuqizime**

Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 55  
**Fillimi i efekteve**

1. Krerët I, II, IV, VI e VII i shtrijnë efektet menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. QKB-ja fillon trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve, në përputhje me këtë ligj dhe kreun V të tij, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, por jo më vonë se data 31.5.2009.
3. Institucionet qendrore kompetente për trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve, sipas legjislacionit përkatës, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të pranojnë kërkesa dhe t'i trajtojnë ato deri në datën e fillimit të trajtimit nga QKB-ja, sipas pikës 2 të këtij neni. Kërkesat në proces dhe të papërfunduara deri në këtë datë trajtohen nga institucionet përkatëse, në përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkuesi tërheq kërkesën dhe vendos ta paraqesë atë pranë QKB-së.
4. Kreu III i shtrin efektet për institucionet pavarura dhe institucionet qendrore, të përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, në datën 31 dhjetor 2009.

**Dispozita kalimtare**  
*(e parashikuar me ligjin nr. 6/2015, datë 12.2.2015)*

1. Ngarkohen të gjitha institucionet qendrore, që kanë lëshuar autorizime deri në afatin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni e që, sipas këtij ligji, trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së, t'i dërgojnë QKB-së të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin që publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, brenda këtij afati.
2. Ngarkohen të gjitha institucionet e pavarura dhe institucionet qendrore, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 15, të ligjit, të publikojnë, brenda datës 31.12.2015, në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e përcaktuar, sipas parashikimeve të këtij ligji për autorizimet e vlefshme e të dhëna prej tyre deri në këtë datë.
3. QKB-ja fillon trajtimin e autorizimeve, në përputhje me këtë ligj dhe kreun V të ligjit, jo më vonë se data 30.9.2015.
4. Institucionet qendrore kompetente për trajtimin e autorizimeve, sipas legjislacionit përkatës, përpara hyrjes në fuqi të kësaj dispozite, vazhdojnë të pranojnë kërkesa dhe t'i trajtojnë ato deri në datën e fillimit të trajtimit nga QKB-ja, sipas pikës 3 të këtij neni. Kërkesat në proces dhe të papërfunduara deri në këtë datë trajtohen nga institucionet përkatëse, në përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkuesi tërheq kërkesën dhe vendos ta paraqesë atë pranë QKB-së.

Neni 56  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6088, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

SHTOJCA 1  
*(Ndryshuar me ligjin nr. 6/2015, datë 12.2.2015 dhe ligjin 37/2016, datë 31.3.2016; nr. 21/2021, datë 22.2.2021 dhe shtuar me ligjin nr. 72/2021, datë 27.5.2021)*

| Nr. | Nr. i fushës/kategorisë | Lloji i kategorisë | Fusha/kategoritë e veprimtarive dhe/ose të të mirave publike e të përdorimeve të tyre |
|-----|-------------------------|--------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
|     | Fusha I                 |                    | Siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile                                   |

|     |                  |         |                                                                                                                                   |
|-----|------------------|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | 1.               | Licencë | Prodhimi dhe/ose tregtimi i mallrave (armë, municione, lëndë, pajisje, teknologji etj.) ushtarake dhe/ose me përdorim të dyfishtë |
| 2   | 2.               | Licencë | Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile                                                                      |
| 3   | 3.               | Licencë | Shërbimi privat i sigurisë fizike                                                                                                 |
|     | <b>Fusha II</b>  |         | <b>Ushqimi dhe shëndeti</b>                                                                                                       |
| 4   | 1.               | Licencë | Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve                                                                                             |
| 5   | 2.               | Licencë | Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare                                                                        |
| 6   | 3.               | Licencë | Rritja ose tregtimi i kafshëve                                                                                                    |
| 7   | 4.               | Licencë | Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose i fidanëve                                                                           |
| 8   | 5.               | Licencë | Prodhimi dhe/ose tregtimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve                   |
| 9   | 6.               | Licencë | Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë                                                                      |
| 10  | 7.               | Licencë | Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë                                                                         |
| 11  | 8.               | Licencë | Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare                                                                          |
| 12  | 9.               | Licencë | Prodhimi dhe/ose tregtimi i pajisjeve mjekësore                                                                                   |
|     | <b>Fusha III</b> |         | <b>Mjedisi dhe burime mjedisore bazë</b>                                                                                          |
| 13  | 1.               | Leje    | Për ndikimin në mjedis                                                                                                            |
| 14  | 2.               | Licencë | Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis                                                             |
| 15  | 3.               | Licencë | Importi i mbetjeve, për qëllim riciklimi, përpunimi dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozonholluese                      |
| 16  | 4.               | Leje    | Shfrytëzimi dhe/ose kultivimi i florës (tokësore dhe/ose ujore)                                                                   |
| 16  | 5.               | Leje    | Shfrytëzimi dhe/ose mbarështimi i faunës (tokësore ose ujore)                                                                     |
| 17  | 6.               | Leje    | Shfrytëzimi i ujërave mbi dhe/ose nëntokësore dhe/ose baseneve e materialeve të tyre                                              |
| 18. | 7.               | Licencë | Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë                                                         |
|     | <b>Fusha IV</b>  |         | <b>Burime minerare, hidrokarbure dhe energjetike</b>                                                                              |
| 20  | 1.               | Leje    | Minerare ose hidrokarbure                                                                                                         |
| 21  | 2.               | Leje    | Për të gjitha rastet që burojnë nga legjislacioni për koncesionet                                                                 |
| 22  | 3.               | Leje    | Rastet dhe llojet e tjera të përdorimit të burimeve me natyrë energjetike.                                                        |
| 23. | 4.               | Licencë | Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushe.                                                         |
|     | <b>Fusha V</b>   |         | <b>Territori dhe ndërtimi</b>                                                                                                     |
| 24  | 1.               | Licencë | Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me zhvillim e territorit dhe/ose ndërtimin                                        |
| 25  | 2.               | Leje    | Zhvillimi territorial dhe/ose ndërtimor                                                                                           |
|     | <b>Fusha VI</b>  |         | <b>Trashëgimia kulturore</b>                                                                                                      |
| 26  | 1.               | Licencë | Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me trashëgiminë kulturore                                                         |
| 27  | 3.               | Leje    | Restaurim dhe/ose rrjetëzimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore                                                              |
| 28  | 4.               | Licencë | Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit                                                                                    |
|     | <b>Fusha VII</b> |         | <b>Transporti</b>                                                                                                                 |
| 29  | 1.               | Licencë | Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve                                                                                        |
| 30  | 2.               | Licencë | Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë                                                                               |

|    |                   |         |                                                                                                                                  |
|----|-------------------|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 31 | 3.                | Licencë | Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor                                                        |
| 32 | 4.                | Licencë | Transport ndërkombëtar detar i automjeteve dhe/ose i udhëtarëve                                                                  |
| 33 | 5.                | Licencë | Për shërbime portuale                                                                                                            |
| 34 | 6.                | Licencë | Për shërbime hekurudhore                                                                                                         |
| 35 | 7.                | Licencë | Për shërbime aeroportuale                                                                                                        |
|    | <b>Fusha VIII</b> |         | <b>Industri dhe shërbime të tjera</b>                                                                                            |
| 36 | 1.                | Licencë | Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose i lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri |
|    | <b>Fusha IX</b>   |         | <b>Arsimi dhe shkenca</b>                                                                                                        |
| 37 | 1.                | Licencë | Arsimi parauniversitar                                                                                                           |
| 38 | 2.                | Licencë | Arsimi i lartë                                                                                                                   |
|    | <b>Fusha X</b>    |         | <b>Kujdesi shoqëror dhe punësimi</b>                                                                                             |
| 39 | 1.                | Licencë | Shërbime të kujdesit shoqëror                                                                                                    |
| 40 | 2.                | Licencë | Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose të formimit profesional                                                     |
|    | <b>Fusha XI</b>   |         | <b>Drejtësia dhe ligji</b>                                                                                                       |
| 41 | 1.                | Licencë | Shërbimi i noterisë                                                                                                              |
| 42 | 2.                | Licencë | Shërbimi i përmbarimit                                                                                                           |
| 43 | 3.                | Licencë | Shërbime të tjera ekspertize ose profesionale të lidhura me të drejtat civile dhe/ose penale                                     |
|    | <b>Fusha XII</b>  |         | <b>Financat publike</b>                                                                                                          |
| 44 | 1.                | Licencë | Për trajtime të favorizuara fiskale dhe/ose doganore                                                                             |
| 45 | 2.                | Licencë | Shërbime ekspertize ose profesionale financiare apo shërbime të lidhura me financat publike                                      |
| 46 | 3.                | Licencë | Organizimi i lojërave të fatit                                                                                                   |
| 47 | <b>Fusha XIII</b> |         | <b>Turizmi</b>                                                                                                                   |
|    | 1.                | Licencë | Agjenci udhëtimi dhe/ose operator turistik                                                                                       |
|    |                   |         |                                                                                                                                  |
|    | <b>Fusha XIV</b>  |         | <b>Teknologji financiare (<i>Fintech</i>) dhe TIK</b>                                                                            |
| 48 | 1.                | Licencë | Shërbime të lidhura me tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë                                 |
| 49 | 2.                | Licencë | Për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit                                                                                 |